



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 268/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani, dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Huluntuëse (BIRN) në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në Prishtinë, për shkak të pa rregullsive gjatë procesit të votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me dt. 12.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa Anr. 268/2014 e dt. 09.06.2014, e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Huluntuëse (BIRN), në Prishtinë,

Arsyetim

Me datë 09.06.2014 PZAP-i, ka pranuar një ankesë, nga Rrjetit Ballkanik për Gazetari Huluntuëse (BIRN) në Prishtinë, në cilën pretendohet se në Qendrën e Votimit (QV) 2115B/04D në shkollën fillore "Halit Geci" komisionarët e PDK kanë ofruar lëngje për votuesit e kësaj qendre.

Më tutje ka theksuar se komisionarët kanë thënë se Hashim Thaqi është më i miri duke bërë me gisht shenjën e PDK-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur një video incizim lidhur me vendin e ngjarjes.

Në bazë të nenit 4.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, PZAP-i e njoftoj lidhur me ankesën Anr.268/14 që është ushtruar ndaj subjektit politik PDK, prandaj dhe i kërkoj që të përgjigjet në ankesë deri me datë 10.06.2014 deri në ora 17:00.

PZAP-i, ka pranuar përgjigjen në ankesë nga subjekti politik PDK ku theksohet se, në video incizimin e ofruar si provë nga BIRN që i ka bashkangjitur ankesës nuk shihet askund komisionari duke shpërndarë pije votuesve dhe as duke bërë thirrje për të votuar PDK.

PZAP-i po ashtu në bazë të nenit 4.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it e njoftoi edhe komisionarin përmes postës elektronike lidhur me ankesën dhe kërkoi të përgjigjet, ku po të njëjtën formë përmes postës elektronike u përgjigj duke thënë se nuk ka qenë komisioner i subjektit PDK por i subjektit LDK duke shtuar se video incizimi që ishte bërë në ditën e votimit e quajti si të paligjshme dhe se në katër VV sa

kanë qenë Policia e Kosovës ka vlerësuar se gjithçka ka shkuar në rregull pa asnjë problem.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Nga pretendimet e cekura në ankesë, del se parashtresja nuk e ka precizuar në mënyrë të drejt ankesën, ngase në përgjigjën në ankesë të komisionarit Përparim Gecaj thuhet se ai nuk ka qenë komisioner nga radhët e subjektit politik PDK por nga radhët e subjektit politik LDK. Dhe se lidhur me pretendimet se ai ka joshur votuesit në VV ku ai ka qenë komisioner nuk qëndrojnë sepse në përgjigjen në ankesë të PDK-së thuhet se në video incizim të ofruar si provë nga BIRN-i nuk shihet një gjë e tillë por kjo ka qenë vetëm një përkdhelje e një të mituri i cili ishte në shoqërim të prindit të tij dhe e tërë kjo nuk ka qenë për të stimuluar për të votuar PDK-në dhe se nga Policia e Kosovës nuk është konstatuar se ka pasur ndonjë parregullsi gjatë ditës së votimit.

Prandaj një pretendim i tillë ankimor është i papërgjegjshëm dhe i pa qartë për tu vërtetuar dhe se për këtë arsye ankesa në fjalë u vlerësua si e pa bazuar, sipas nenit 3.6 pika c) të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

Anr. 268/2014 më datën 12.06.2014

Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*